



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

STATUTI

I

SHOQATËS SË PËLLUMBAVE AKROBATIKË (rrotullues) TË
KOSOVËS NË ZVICËR

SHPAKZ



"DARDANIA"



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

Shoqata e Pëllumbave Akrobatikë (rrotullues) të Kosovës në Zvicër - "DARDANIA"

1. Emri dhe vendi

Shoqata e Pëllumbave Akrobatikë (rrotullues) të Kosovës në Zvicër është themeluar më 04.02.2006 në Basel dhe selia e saj do të jetë gjithmonë aty ku edhe do të banojë kryetari i kryesisë së Shoqatës. Shoqata përbëhet nga nëndegët e saj, të karakterizuara nga llojet e pëllumbave: në ata rrotullues, gjylija dhe lart fluturuesit

2. Qëllimi dhe detyrat

SHPAKZ Dardania i ka caktuar vetes për detyrë zgjerimin e rrjetit të pëllumbave garues si dhe llojeve të tjera të pëllumbave me prejardhje nga Kosova por të cilët nuk marrin pjesë nëpër gara, me të vetmin qëllim përfaqësimin e Kosovës nëpër ekspozitat ndërkombëtare në këtë lami të sportit. SHPAKZ është shoqatë apolitike dhe jo fetare, është neutrale dhe ndalohet politizimi i shoqatës nga cilido qoftë anëtar.

Detyrat e SHPAKZ Dardania:

- a) Përfshirja dhe përkujdesja e të gjithë shqiptarëve të interesuar në Zvicër për kultivimin e sportit të pëllumbave garues nga Kosova.
- b) Këshillimi i anëtarëve kultivues të pëllumbave nga Kosova.
- c) Organizimi i garave të fluturimeve të pëllumbave.
- d) Drejtimin e punës kultivuese të anëtarëve për një përsosmëri të fluturimeve të pëllumbave në garat e veçanta.
- e) Kontrollimi dhe verifikimi i pëllumbave të bëhet duke i marrë të dhënat dhe numrin e unazës në këmbët e pëllumbave.
- f) Verifikimin e vazhdueshëm të rregullave të garave përherë e bëjnë ata të cilët e njohin mirë garën përkatëse.
- g) Arbitri vlerësues duhet të jetë njohës i mirë i kësaj lëmie.

3. Anëtarësia e shoqatës Dardania

- a) Në SHPAKZ Dardania mund të jenë anëtarë të rregullt të gjithë ata shqiptarë të cilët merren me kultivimin dhe ruajtjen e pëllumbave garues nga Kosova, të cilët jetojnë dhe punojnë në Zvicër.
- b) Kultivuesit e rinj nën moshën 16 vjeçare në SHPAKZ gëzojnë të drejta të barabarta me anëtarët e tjerët të shoqatës, por që paguajnë një gjysmë kuote të anëtarësisë.
- c) Simpatizantë të SHPAKZ Dardania mund të jenë të gjithë ata persona që e përkrahin shoqatën, e ndihmojnë atë materialisht dhe ndjekin aktivitetet e shoqatës.
Simpatizantët nuk gëzojnë të drejtën e votimit gjatë zgjedhjes së organeve drejtuese të shoqatës.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

- d) Anëtar nderi në SHPAKZ mund të jenë persona të propozuar nga kryesia, zakonisht persona të veçantë të cilët kanë kontribuar për rritjen dhe konsolidimin e shoqatës.

4. Anëtarësimi në shoqatë

Anëtarësimi në SHPAKZ bëhet përmes deklaramentit vullnetar të personave të interesuar përmes plotësimit të fletanëtarësimi dhe nënshkrimit të saj.

Anëtarët e shoqatës i kanë të drejtat dhe detyrimet e barabarta. Askush nuk mund të ketë përparësi ndaj të tjerëve e as të anashkalohet nga të tjerët.

Çdo anëtarë gëzon të drejtën e votimit dhe të zgjedhjes në strukturat e shoqatës.

5. Detyrat dhe të drejtat e anëtarëve të SHPAKZ Dardania

Anëtarët gëzojnë të drejta të barabarta në shoqatë.

Favorizimi apo diskriminimi në mënyrë tendencioze në SHPAKZ Dardania është i ndaluar.

- Statuti apo rregullat në SHPAKZ duhet respektuar me sinqeritet.
- Puna në SHPAKZ duhet përkrahur fuqishëm në drejtim të përparimit.
- Kultivim ose mbajtja e pëllumbave si hobi ose si garues duhet të jenë në përputhje me rregullat e shtetit.
- Detyrimet ndaj SHPAKZ duhet kryer në afat 6 muaj që kontributi të jetë më efektiv. Vonesa ose shkelja e këtij afati do të ketë për pasojë përjashtimin nga shoqata.
- Gara duhet të jetë e organizuar mirë dhe shumë korrekte.
- Për propozimin e një tubimi të anëtarësisë duhet që kryetari të njoftojë anëtarësinë me shkrim 4 javë më parë

6. Shuarja e anëtarësisë

- Dorëheqja në mënyrë vullnetare nga SHPAKZ.
- Në rast vdekjeje të ndonjë anëtari të shoqatës.
- Ikja nga SHPAKZ bëhet për shkak të qëndrimeve apo pikëpamjeve të kundërta ndaj statutit ose të mbretërimi të një klime jo të mirë në mesin e anëtarësisë dhe mos puna efikase e drejtuesve të lartë.
- Nëse parashtron ndokush pikëpamje ose bën shkelje të ligjit, normave ose rregullave, ose bën veprime të palejueshme.
- Arsyetimi i largimit duhet bërë me shkrim. Për largimin vendosë kryesia.
- Për ndarjen e SHPAKZ ose synimin për ta marrë udhëheqjen nuk mund të vendosë asnjë person, por vendos kuvendi i shoqatës.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

7. Organet në SHPAKZ

a) Kryesia përbëhet nga:

kryetari

sekretari

arkëtari dhe

2 anëtarë të kryesisë

Mandati i kryesisë zgjatë një vit dhe bëhet me rotacion. Kryesia ka përgjegjësi që në situata të papritura nga fondi i SHPAKZ të shfrytëzojë vetëm CHF 300.-

b) Kryetari, drejton dhe përfaqëson SHPAKZ duke i respektuar rregullat e ligjet e saja. Ai thërret dhe drejton mbledhjet e kryesisë dhe kuvendin e shoqatës.

c) Nënkryetari, i cili në rast të mungesës së kryetarit drejton mbledhjet e kryesisë dhe kuvendin e shoqatës.

d) Sekretari mbanë procesverbalet e mbledhjeve të kryesisë dhe kuvendeve. Ai duhet të bashkëpunojë me kryetarin dhe nënkryetarin e shoqatës.

e) Arkëtari menaxhon arkën, të hyrat dhe shpenzimet e shoqatës. Njëkohësisht harton buxhetin për vitin vijues, si dhe

f) 2 anëtarë të kryesisë

Kryetari dhe sekretari në procesin e zgjedhjeve nuk mund të vihen në dispozicion njëkohësisht.

Rizgjedhja e pranueshme

a) Kuvendi mund të vendosë për shkarkimin para kohe të gjithë atyre të cilët i shkaktojnë dëm shoqatës. Për thirrjen e kuvendit duhet bërë kërkesë me shkrim nga ana e kryesisë. Afati i kërkesës duhet të jetë 4 javë para thirrjes së kuvendi dhe kjo duhet t'i dorëzohet nënkryetarit.

b) Kryetari është ai i cili drejton SHPAKZ dhe ka detyrime ndaj organeve të saj dhe njëkohësisht e përfaqëson atë. Kryetari e thirr dhe drejton mbledhjen e kryesisë.

c) Sekretari para çdo mbledhjeje të kryesisë duhet ta ketë procesverbalin e gatshëm të mbledhjes paraprake.

d) Arkëtari është i mandatar për t'u kujdesur për mjetet e SHPAKZ, t'i mbledh pagesat e anëtarësisë me rregull dhe në rast nevojë ata të cilët nuk i kryen obligimet ndaj shoqatës ka të drejtë t'iu bëjë vërejtje atyre dhe njëkohësisht ta menaxhojë mirë fondin e shoqatës.

e) Kryesia takohet rregullisht një herë në katër muaj, pra, tri herë në vit dhe sipas nevojës.



DARDANIA



SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR

8. Kuvendi i anëtarësisë

a) Në Kuvendin e SHPAKZ kanë të drejtë vote të gjithë anëtarët aktivë (simpatizuesit nuk kanë të drejtë vote).

Thirrjen për kuvendin e anëtarësisë duhet dërguar me shkrim dhe ftesa duhet bërë 3 javë përpara kuvendit.

Kuvendi i anëtarësisë vendosë me shumicën e thjeshtë të votave, pa marrë parasysh numrin e anëtarëve që prezantojnë në kuvend. Në rast të votave të barabarta, vendos vota e kryetarit.

b) Kuvendit i SHPAKZ ka për detyrë:

- të zgjedh komisionin zgjedhor,
- të vendos për mjetet e fondit, buxhetin dhe kontributet
- të bëjë ndryshime statusore
- të zgjedh kryesinë e shoqatës,
- të shuaj shoqatën (për këtë duhet të jenë 3/4 e votave të shumicës së anëtarëve të kuvendit të shoqatës),
- të caktojë garat fluturuese të pëllumbave dhe monitorimin
- të miratojë rregullat e garave fluturuese të pëllumbave për grupet veç e veç

Mandati i anëtarëve të zgjedhur nëpër organet e shoqatës është një vjeçar.

9. Mundësia e bashkimit

Pas zgjedhjeve në SHPAKZ, të ngarkuarit nga Kryesia e zgjedhur e Shoqatës do të punojnë me nëngrupet drejt bashkimit të mundshëm të tyre me Shoqatën. Lidhur me këto bisedime nuk do të bëhet publike në media pa përfunduar bashkimi i këtyre nëngrupeve.